

**RREGULLORE PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT TE KUSHTEVE
TEKNIKE DHE LIDHJES SË KONSUMATORËVE NË SHËRBIMET E
UJËSJELLËSIT**

Mars, 2026

Në bazë të nenit 34 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligji nr.05/L-009, si dhe bazuar në nenin 7 në Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale Ujësjellësi "Prishtina" Sh.A., Bordi i Drejtorëve miratoi këtë:

**Rregullore
për Procedurat e Aplikimit për Kushtet Teknike dhe lidhjes së Konsumatorëve në
Shërbimet e Ujësjellësit**

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat e detajuara që duhet të aplikohen nga zyrtarët e kompanisë dhe aplikuesit për lëshimin e kushteve teknike dhe lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit.

2. Qëllimi i rregullores është:

2.1 Të vendos një kornizë mbi të cilën kompania planifikon, zbaton dhe mbikëqyr procedurat gjatë aplikimit të kushteve teknike dhe lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit.

2.2 Të definojë veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga personeli i kompanisë në rastet e procedimit të aplikacioneve për lëshimin e kushteve teknike, pëlqimin për kyçje në sistemin e ujësjellësit dhe legalizimin e kyçjeve në rrjetin e ujësjellësit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon:

- 1.1 **Ankesë** - është çdo kundërshtim apo raportim në çfarëdo forme të pakënaqësisë së konsumatorit me cilindo aspekt të shërbimeve që ofron ofruesi i shërbimeve
- 1.2 **Kërkesë** - çdo kërkesë e bërë me shkrim nga konsumatori në lidhje me cilindo aspekt të shërbimeve që ofron ofruesi i shërbimeve
- 1.3 **ARRU** - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

- 1.4 **KRU** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit
- 1.5 **DPZH** - Departamenti për planifikim dhe zhvillim
- 1.6 **DUP** - Departamenti për ujë të pijes
- 1.7 **DUN** - Departamenti për ujëra të ndotura
- 1.8 **NJOU** - Njësi operative e ujësjellësit
- 1.9 **DKK** - Departamenti i kujdesit për konsumatorëve;
- 1.10 **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve dhe/ose pranon shërbime nga Ofruesi i shërbimeve
- 1.11 **Komisioni** - Komisioni i formuar nga KE për inspektim
- 1.12 **Data baza** - Softuer i përdorur nga KRU "Prishtina" Sh.A. për ruajtjen e të dhënave (CRM)
- 1.13 **Lidhja e autorizuar** - lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, të ofruara nga ofruesi i shërbimeve sipas ligjit
- 1.14 **Lidhja e pa autorizuar** - lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit që nuk është kryer nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me ligjin.

Neni 3 Zbatueshmëria

- 1. Kjo rregullore është dokument zyrtar dhe si e tillë është obligative të zbatohet nga i gjithë personeli i kompanisë që është i përfshirë në procedurat e lëshimit të kushteve teknike dhe lidhjen e konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 2. Mosrespektimi i kësaj rregullore paraqet shkelje të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore konform procedurës disiplinore të kompanisë.
- 3. Për interpretimin e kësaj rregullore dhe procedurave të përcaktuara me këtë rregullore, si dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta, duhet të kontaktohet zyra ligjore e kompanisë.

Neni 4 Baza ligjore

- 1. Korniza ligjore për lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është përcaktuar me:
 - 1.1 Ligjin nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit
 - 1.2 Ligjin nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit
 - 1.3 Rregulloret e miratuara nga ARRU në bazë të Ligjit:
 - 1.3.1 Rregullorja nr. 10/2019 për Standardet Minimale për Shërbimet e Ujit,

1.3.2 Rregullore nr.13/2021 për Kartën e Konsumatorit dhe Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit

Neni 5

Parimet e kompanisë për lidhjen e konsumatorëve në shërbime

1. Parimet bazë për lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë të bazuara në Ligj dhe njëkohësisht demonstrojnë përkushtimin e kompanisë për:
 - 1.1 Ngritjen e shkallës së mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - 1.2 Ofrimin e shërbimeve në zonën e shërbimit, kurdo që është teknikisht dhe financiarisht e realizueshme;
 - 1.3 Trajtimin e drejtë dhe të barabartë të gjithë konsumatorëve;
 - 1.4 Pengimin e lidhjeve ilegale dhe dukurive tjera abuzive në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - 1.5 Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të infrastrukturës së ujësjellësit.

KREU II

PROCEDURA E APLIKIMIT PËR KUSHTET TEKNIKE DHE LIDHJES NË SHËRBIME

Neni 6

Dorëzimi i aplikacionit për kushte teknike

1. Aplikuesi për kushte teknike për ujësjellës dhe kanalizim duhet të plotëson dhe të dorëzon aplikacionin standard tek zyrtari përgjegjës i DKK-së.
2. Aplikuesi mund të aplikoj edhe online dhe të vendosë dokumentet e kërkuara sipas standardit të përcaktuar në WEB aplikacion në përputhje me aplikacionin e rregullores.
3. Për t'u konsideruar i kompletuar aplikacioni duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm që është i specifikuar në formularin e aplikacionit përkatës.

Neni 7

Procedurat pas aplikimit për kushte teknike

1. Zyrtari përgjegjës nga DKK e protokollon aplikacionin dhe e dorëzon te komisioni përkatës i cili bënë inspektimin në terren dhe hartimin e procesverbalit. Komisioni përkatës përgjegjës për inspektim në terren e bën verifikimin e kodeve dhe borxheve në parcelat përkatëse (në rastet kur ka objekte të rrënuara) dhe me proces lëndën e dorëzon në DKK, dhe pas shlyerjes së borxheve dhe pasivizimit të kodeve, brenda afatit prej 15 ditë pune lëndën e kompletuar me proces e skanon, ngarkon në Data bazë dhe e delegon te zyrtari përgjegjës në

DPZH. Në rast të mos përmbushjes së kriterëve lënda refuzohet dhe aplikuesi njoftohet me arsyet e refuzimit.

2. Zyrtari përgjegjës i DKK aplikacionin e kompletuar për kushte teknike e ngarkon në Data bazë në afat prej tre (3) ditëve të punës dhe e delegon te zyrtari përgjegjës në DPZH.

3. Personi përgjegjës nga DPZH në afat prej dhjetë (10) ditëve të punës, e shqyrton lëndën dhe lëshon vendimin për aprovimin apo refuzimin e kushtet teknike.

4. Në raste të aprovimit të kërkesës, aplikuesit i lëshohet vendimi me dokumentet përcjellëse, si: specifikimet teknike, skicat, etj.

5. Në rast të refuzimit të kërkesës, aplikuesit i lëshohet vendimi me arsyet për refuzim.

6. Zyrtari përgjegjës i DPZH në afat prej dy (2) ditëve pune e njofton aplikuesin me e-mail apo sms për vendimin mbi aprovimin apo refuzimin e kërkesës dhe njëkohësisht lënda duhet të mbyllet në Data bazë.

7. Procedimi i aplikacionit dhe marrja e vendimit për aprovimin ose refuzimin duhet të kryhet në afat prej tridhjetë ditë (30) kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit të kompletuar dhe të ngarkuar në Data bazë.

Neni 8

Dorëzimi i aplikacionit për lidhje

1. Aplikuesi për lidhje në shërbimet e ujësjellësit apo kanalizimit e plotëson dhe e dorëzon aplikacionin standard për lidhje tek zyrtari përgjegjës i DKK-së.

2. Aplikuesi mund të aplikoj edhe online dhe të vendosë dokumentet e kërkuara sipas standardit të përcaktuar në WEB aplikacion në përputhje me aplikacionin e rregullores.

3. Për tu konsideruar i kompletuar aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm që është i specifikuar në formularin e aplikacionit përkatës.

Neni 9

Procedurat pas aplikimit për lidhje

1. Aplikuesi për lidhje në ujësjellës dhe kanalizim duhet të plotëson dhe të dorëzon aplikacionin standard tek zyrtari përgjegjës i DKK-së.

1.1 Zyrtari përgjegjës i DKK aplikacionin e kompletuar për lidhje individuale ose kolektive, e skanon dhe e ngarkon në Data bazë më së voni në ditën e ardhshme të punë dhe e cakton te zyrtari përgjegjës në DPZH.

1.2 Zyrtari përgjegjës në DPZH pranon lëndën në ditën e ardhme të punës përmes Data bazës dhe fillon shqyrtimin e lëndës.

1.3 Zyrtari përgjegjës nga DPZH, në afat prej tri (3) ditëve të punës e njofton me e-mail zyrtarin e Departamentit të Mirëmbajtjes (Operative) sipas nevojës-kërkesës për datën e daljes në vend të ngjarjes për të përcaktuar detajet teknike të lidhjes, dhe njëkohësisht njofton me e-mail edhe komisionin për inspektim në teren.

1.4 Data e daljes në vendin e ngjarjes nga Operativa nuk duhet të jetë më vonë se pesë (5) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës nga zyrtari përgjegjës i DPZH.

Paraprakisht aplikuesi njoftohet për vizitën në teren.

- 1.5 Zyrtaret përgjegjës nga shërbimi i operatives pas inspektimit në teren, në afat prej dy ditëve (2) përcjellin me e-mail-procesin e terrenit tek zyrtari përgjegjës i DPZH-së.
- 1.6 Data e daljes në vendin e ngjarjes nga Komisioni nuk duhet të jetë më vonë se pesë (5) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës nga zyrtari përgjegjës i DPZH. Paraprakisht aplikuesi njoftohet për vizitën në teren.
- 1.7 Pas inspektimit në teren, Komisioni në afat prej dy ditëve (2) merr vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës.
- 1.8 Në rast të mos plotësimit të kriterëve, aplikuesit i jepen vërejtjet dhe njoftohet me e-mail që në afat prej 15 ditë pune të bëjë përmirësimin e vërejtjeve.
- 1.9 Pas përmirësimit të vërejtjeve dhe njoftimit nga aplikuesi, komisioni e bën verifikimin e përmirësimeve e pastaj përmes e-mailit e njofton zyrtarin përgjegjës të DPZH-së dhe Menaxherin e DPZH-së duke ia bashkangjitur raportin final i cili duhet të jetë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit, dhe njëkohësisht të departamentet përkatëse përmes e-mailit e dërgon listën e konsumatorëve për hapjen e kodeve dhe nënshkrimin e kontratave.
- 1.10 Në rastet kur nga aplikuesi nuk bëhen përmirësimet në afatin kohor, komisioni përmes e-mailit njofton zyrtarin përgjegjës të DPZH-së dhe Menaxherin e DPZH-së duke ia bashkangjitur raportin final për refuzimin e lidhjes i cili duhet të jetë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe lënda mbyllet në data bazë nga DPZH.
- 1.11 Në rast të aprovimit, komisioni përmes e-mailit e njofton zyrtarin përgjegjës të DPZH-së dhe Menaxherin e DPZH-së duke ia bashkangjitur raportin final i cili duhet të jetë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit, dhe njëkohësisht të departamentet përkatëse përmes e-mailit e dërgon listën e konsumatorëve për hapjen e kodeve dhe nënshkrimin e kontratave.
- 1.12 Pas hapjes së kodeve dhe nënshkrimit të kontratave, shërbimi përkatës obligohet t'i kthejë listat e konsumatorëve me kode të Komisioni, Zyrtari përgjegjës i DPZH-së, Menaxheri i DPZH-së dhe Shërbimin e GIS-it për regjistrim në data bazën e GIS.
- 1.13 Zyrtari përgjegjës nga DPZH në afat prej dy (2) ditëve të punës, përgatitë vendimin për aprovim të lidhjes bazuar në raportin e komisioni dhe dokumentet e plotësuar sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore.
- 1.14 Zyrtari përgjegjës i DPZH-së në afat prej dy (2) ditëve pune e njofton aplikuesin me e-mail ose SMS për vendimin mbi aprovimin për lidhje në rrjetin e shërbimeve të ujit, dhe kanalizimit dhe e informon për kushtet në vijim:
 - 1.14.1 kryerjen e pagesës për shpenzimet e lidhjes sipas rregullores së ARRU-së,
 - 1.14.2 Zyrtari nga shërbimi financiar në bazë të kushteve dhe tarifave të shërbimit të aprovuara nga ARRU-ja përpilon faturën me shpenzimet e lidhjes dhe të gjitha taksat që duhet të paguhet nga aplikuesi përfshirë dhe tarifat e mbingarkesës së infrastrukturës të shërbimit të aprovuar nga ARRU për vitin 2026 dhe i dërgon DPZH faturat-pagesat.
 - 1.14.3 nxjerrjen e lejes nga autoritetet komunale për lejimin e gërmimit nëse ka nevojë.

- 1.15 Pas regjistrimit të konsumatorëve, nënshkrimit të kontratave dhe kryerjes së pagesave zyrtari përgjegjës i DPZH-së njofton përmes e-mailit shërbimin e Operatives për daljen në teren dhe realizimin e lidhjes.
- 1.16 Shërbimi i GIS në afat prej dy ditëve (2) nga pranimi i listës finale të konsumatorëve duhet të bëjë regjistrimin e konsumatorë me kode në data bazën e GIS-it si dhe të dhënat e lidhjes.
- 1.17 Procedimi i aplikacionit për lidhje dhe marrja e vendimit për aprovimin ose jo të aplikacionit duhet të kryhet në afat prej tredhjet (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit të kompletuar, përveç rasteve specifike (zona më të gjëra të trajtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit) kur nevojitet kohë më e gjatë për të gjetur zgjidhje teknike, por ky afat duhet të jetë maksimum 60 ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit në data bazë.

Neni 10 Realizimi i lidhjes

1. Aplikuesi pas marrjen se lejeve nga institucionet përkatëse e dërgon përmes e-mailit-dëshminë e lejeve te zyrtari përgjegjës i shërbimit të operatives-DUP dhe zyrtari përgjegjës i DPZH-se.
 - 1.1 Udhëheqësi i operatives në datën e caktuar për realizimin e lidhjes së re, përgatitë urdhëresën e punës dhe cakton ekipin për realizimin e lidhjes, bashkë me kërkesën për material i cili duhet të merret në depon e kompanisë, ose materialin adekuat që mund të sigurohet nga pala, e dokumentuar me deklaratë e cila do të jetë pjesë e dosjes.
 - 1.2 Ekipi për realizimin e lidhjes merr materialin e nevojshëm nga depoja e kompanisë dhe pasi të ketë konstatuar se ekzistojnë kushtet, në koordinim me aplikuesin do ta realizoj lidhjen sipas normave teknike të kompanisë.
2. Pas realizimit të lidhjes, kryepunëtori i ekipit të operativës konstaton në urdhëresën e punës se lidhja është kryer dhe shënon detajet e nevojshme për lidhjen e ekzekutuar (Incizimi gjeodezik materiali i harxhuar, diametri i gypit, profili, tipi dhe numri serik i ujëmatësit etj.). Këto informacione i dorëzon tek udhëheqësi i operativës.
3. Udhëheqësi i operativës ia përcjellë një kopje të urdhëresës së punës përmes e-mail shërbimit të GIS/Gjeodezi me informacionet e lidhjes së realizuar dhe të dhënat e incizimit gjeodezik, identifikimin e materialit, diametrin e gypit për t'u regjistruar në sistemin e GIS-it.

KREU III

PROCEDURAT PËR LIDHJEN E KONSUMATORËVE

Neni 11

Kushtet për lidhje

1. Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit mund të realizohet vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga kompania.

1.1 Kompania i përcakton kushtet për lidhje në bazë të procedurave dhe kriterëve teknike të përcaktuara nga KRU Prishtina si dhe rregulloreve të përcaktuara nga ARRU.

1.2 Kompania përcakton piken e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe diametrin dhe materialet që do të përdoren për punimin e lidhjes.

2. Aplikuesi për lidhje është i obliguar që të sigurojë:

2.1. të gjitha pëlqimet dhe lejet e nevojshme nga organet kompetente;

2.2. të kryejë të gjitha punimet e nevojshme tokësore në bazë të udhëzimeve të kompanisë;

2.3. është përgjegjës për të gjitha dëmet që mund të shkaktohet me rastin e kryerjes së punimeve tokësore;

2.4. është i obliguar që të paguajë të gjitha shpenzimet e lidhjes sipas tarifave të aprovuar nga ARRU;

2.5. të përgatisë vendin dhe ndërtoj pusëtën e ujësjellësit për montim të ujëmatësit, sipas formës dhe dimensioneve të përcaktuara nga kompania;

2.6. të instaloj ujëmatësit individual dhe kasetat shpërndarëse në korridore;

2.7. të përgatisë vendin dhe ndërtoj pusëtën kontrolluese të kanalizimit fekal para pusëtes së kyçjes në kolektorin ekzistues (ndërmjet vijës ndërtimore dhe Rregullative),

2.8. Obligohet të bëjë ndarjen e kanalizimit fekal nga ai atmosferik dhe të vendos pusëtat të ndara, para pusëtes së kyçjes në kolektorin ekzistues.

3. Kompania i kalkulon dhe faturon shpenzimet e lidhjes në bazë të tarifave në fuqi të aprovuara nga ARRU. Pas kryerjes së punimeve kompania e bënë llogarinë përfundimtare – faturën për punët e përfunduara.

Neni 12

Punimi i lidhjes

1. Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit kryhet nga kompania. Lidhja mund të kryhet edhe nga kontraktori i pavarur me kusht që një gjë e tillë të bëhet nën mbikëqyrjen dhe pranimin teknik të kompanisë.

2. Lidhjet të cilat janë kryer pa autorizimin e kompanisë, do të konsiderohen si lidhje të paautorizuara (ilegale) dhe do të ndërpriten.

3. Në raste të veçanta kompania mund të vendosi që t'i legalizojë këto lidhje me kërkesën e pronarit të lidhjes me kusht që:

3.1. lidhja të jetë e punuar sipas normave dhe standardeve të pranueshme për Kompaninë, si dhe,

3.2. të paguhet të gjitha obligimet ndaj kompanisë të faturuara në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Punimet tokësore parimisht nuk kryhen nga kompania. Me kërkesën specifike të aplikuesit për lidhje, kompania mund t'i kryejë edhe punët tokësore dhe në këtë rast aplikuesi për lidhje i bart shpenzimet në bazë të çmimeve të Kompanisë për këto lloje të punimeve.

Neni 13

Shpenzimet e punimit të lidhjes

1. Aplikuesi për lidhje është përgjegjës për mbulimin e të gjitha shpenzimeve që shkaktohen në lidhje me realizimin e lidhjes. Ai është përgjegjës edhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me nxjerrjen e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme.

Neni 14

Instalimi i ujëmatësit

1. Të gjitha lidhjet e reja në shërbimet e ujësjellësit duhet të kenë të instaluar ujëmatësin e tipit, diametrin dhe kapacitetin matës ashtu siç e përcakton kompania në kushtet teknike. Lokacioni për vendosjen e ujëmatësit, si dhe dimensionet e pusetes së ujëmatësit përcaktohen nga kompania. Një rregull e tillë vlen edhe për lidhjet e përkohshme të cilat shfrytëzohen gjatë fazës së ndërtimit të objektit/ve.

2. Aplikuesi për lidhje/konsumatori është përgjegjës për mbulimin e të gjitha shpenzimeve që lidhen me blerjen dhe instalimin e ujëmatësit për herë të parë.

3. Konsumatori është përgjegjës që të ruaj ujëmatësin dhe vulën (pllomben) prej dëmtimeve fizike. Rreptësisht ndalohet që konsumatori apo personat tjerë të pa-autorizuar të manipulojnë me ujëmatësin në çfarëdo forme. Një veprim i tillë i nënshtrohet masave ndëshkimore sipas legjislacionit të zbatueshëm.

4. Kompania i bart shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt dhe zëvendësimit të ujëmatësit, nëse ajo ka mëdyshje për funksionalitetin e tij. Mirëpo, në rast se ujëmatësi dëmtohet qëllimisht nga konsumatori apo si pasojë e neglizhencës dhe moskujdesit të tij, atëherë konsumatori i bart shpenzimet e riparimit, kalibrimit apo zëvendësimit të tij sipas tarifave të përcaktuara nga ARRU.

Neni 15
Dëmet në sistemin e kanalizimit

1. Kompania nuk mban përgjegjësi në rast të dëmeve që mund ti shkaktohen konsumatorit nga përmbytja me ujëra të zeza nga sistemi i kanalizimit, në rast se këto dëme kanë ndodhur si pasojë e mos-instalimit apo mosfunksionimit të pajisjeve mbrojtëse (valvuleve jo-kthyese).

KREU IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret, rregullat dhe vendimet që kanë të bëjnë me procedurat e aplikimit të kushteve teknike, lidhjen dhe rilidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.


Neni 17
Hyrja në Fuqi

1. Kjo rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë kalendarike pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve, si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të KRU "Prishtina" Sh.A. Prishtinë.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
Zt. Bashkim Pllana



Shtojcë: Paraqitja skematike e procedurës së Aplikimit për Lidhje



-Në rast të plotësimit të kriterëve teknike

(Komisioni)

Komisioni përmes e-mailit e njofton zyrtarin përgjegjës të DPZH-së dhe Menaxherin e DPZH-së duke ia bashkangjitur raportin final të nënshkruar nga anëtarët e komisionit, dhe njëkohësisht te departamentet përkatëse përmes e-mailit e dërgon listën e konsumatorëve për hapjen e kodeve dhe nënshkrimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve.

2
D
I
T
Ë

Hapi 5:

Procedimi i Aplikacionit

Për lidhje
(DPZH)

Zyrtari përgjegjës nga DPZH-ja ne afat prej dy (2) ditëve të punës kërkon nga Aplikuesi me E-mail ose SMS për:

- Kryerjen e pagesës sipas rregulloreve të ARRU-së,
- nxjerrjen e lejes nga autoritetet komunale për lejimin e gërmimit nëse ka nevojë.

Zyrtari përgjegjës nga DPZH-ja ne afat prej dy (2) ditëve të punës përmes e-mailit kërkon nga zyrtari i shërbimit financiar të përgatis faturën për shpenzimet e lidhjes dhe të gjitha taksave që duhet të paguhet nga aplikuesi sipas rregulloreve të ARRU-së.

2
D
I
T
Ë

Hapi 6:

Përgatitja e faturës sipas rregulloreve të ARRU

(Shërbimi financiar)

Hapja e Kodeve dhe Nënshkrimi i Kontratave (DKK)
(D???)

Zyrtari nga Shërbimi Financiar pas përgatitjes së faturës, në ditën e njëjtë përmes e-mailit ose SMS-it e njofton Aplikuesin për ta kryer pagesën, dhe pas kryerjes së pagesës nga aplikuesi, dërgon konfirmimin te zyrtari përgjegjës në DPZH.

Pas hapjes së kodeve dhe nënshkrimit të kontratave, shërbimet përkatëse obligohen t'i kthejnë te Komisioni, Zyrtari përgjegjës i DPZH-së, Menaxheri i DPZH-së dhe Shërbimi i GIS-it, konfirmimet për regjistrimin e listave të konsumatorëve me kode dhe nënshkrimin e kontratave nga konsumatorët

5
D
I
T
Ë

Hapi 7:

Procedimi i Aplikacionit Për lidhje

(DPZH)

Zyrtari përgjegjës nga DPZH-ja pas pranimit të:

- Konfirmimit për kryerjen e pagesës,
- Konfirmimit për nënshkrimin e kontratave,
- Dëshmisë së lejes nga komuna, të ofruar nga Aplikuesi,

Përgatit VENDIMIN PËR APROVIM dhe përmes e-mailit njofton Shërbimet e Operativës për daljen në teren dhe realizimin e lidhjes

2
D
I
T

Hapi 8:Realizimi i
Lidhjes

(DUP)

(DUN)

Ekipi nga Operativa merr materialin e nevojshëm dhe në koordinim me aplikuesin e realizon lidhjen sipas normave teknike të kompanisë. Pas realizimit të lidhjes, shërbimit të GIS-it ia përcjellë përmes e-mailit të dhënat e inçizimit gjeodezik, identifikimin e materialit, diametrin e gypit.

2
D
I
T
Ë**Hapi 9:**Regjistrimi
në GIS

(DPZH)

Shërbimi i GIS në afat prej dy ditëve (2) nga pranimi i listës dhe dokumentacionit duhet të bëjë regjistrimin e konsumatorëve me kode dhe kordinata në databazën e GIS-it si dhe të gjitha të dhënat e kyçjes.

2
D
I
T
Ë

Procedimi për lidhje duhet të kryhet në afat prej tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit të kompletuar, përveç rasteve specifike (zona më të gjëra të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit) kur nevojitet kohë shtesë për të gjetur zgjidhje teknike, por ky afat duhet të jetë maksimum 60 ditë kalendarike prej datës së aplikimit).

APLIKACION PËR KUSHTE TEKNIKE

[Të plotësohet nga KRU "PRISHTINA" Sh.a]

Numri i lëndës: _____

Data: ____/____/____

[Plotësohet nga Aplikuesi]

1. INFORMACIONE PËR APLIKUESIN:

Konsumator Shtëpiak:	☐	Objekt Kolektiv:	☐
Konsumator Komercial:	☐	Institucional/Industrial:	☐

Emri dhe mbiemri		Nr. personal													
Adresa															
Nr. i telefonit											e-mail				

2. INFORMACIONE PËR OBJEKTIN QË DO TË NDËRTOHET:

Emri i Biznesit															
Emërtimi i Objektit															
Adresa															
Nr. Biznesit											Nr. TVSH				
Nr. i telefonit											e-maili				

3. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:

a. Kopja e letërnjoftimit,	
b. Vendimi për Kushtet Ndërtimore (Lëshuar nga Komuna përkatëse),	
c. Kopja e planit,	
d. Çertifikata e Pronës,	
e. Lista e njesive banesore dhe lokaleve (forma standarde e KRUP) ¹	
f. Pasivizimi i kodeve (Borgji 0) dhe hapja e kodit të ri	

4. Informacione shtesë:

Nënshkrimi i aplikuesit: _____

Data: ____/____/____

¹ Forma standarde e dhënë nga KRU Prishtina bashkë me vendimin për Kushtet Teknike

APLIKACION PËR KYÇJE INDIVIDUALE

[Plotësohet nga KRU "PRISHTINA" Sh.a]

Numri i lëndës: _____

Data: ____/____/____

[Plotësohet nga Aplikuesi]

1. INFORMACIONE PËR APLIKUESIN:

Emri dhe mbiemri		Nr. personal											
Adresa													
Nr. i telefonit			e-maili										

2. INFORMACIONE PËR OBJEKTIN QË DO TË KYÇET:

Emërtimi i Objektit			
Adresa			
Nr. i telefonit		e-maili	

3. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:

a. Kopja e letërnjoftimit	
b. Kopja e planit	
c. Çertifikata e pronës	
d. Vendimi për Kushtet Teknike (Nga KRU Prishtina) ¹	
e. Leja e ndërtimit ²	
f. Inçizimi gjeodezik i rrjetit të Ujësjetësit dhe Kan. Fekal	

4. Informacione shtesë:

Nënshkrimi i aplikuesit: _____

Data: ____/____/____

¹ Vlenë për zonat që ekziston plani urbanistik

² Vlenë për zonat që ekziston plani urbanistik

APLIKACION PËR KYÇJE KOLEKTIVE

[Të plotësohet nga KRËJ "PRISHTINA" Sh.a]

Numri i lëndës: _____

Data: ____/____/____

[Plotësohet nga Aplikuesi]

1. INFORMACIONE PËR APLIKUESIN:

Emri dhe mbiemri	Nr. personal																
Adresa																	
Nr. i telefonit	e-mail																

2. INFORMACIONE PËR OBJEKTIN QË DO TË KYÇET:

Emri i Biznesit			
Emërtimi i Objektit			
Adresa			
Nr. Biznesit	Nr. TVSH		
Nr. i telefonit	e-maili		

3. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA:

a. Vendimi për Kushtet Teknike (Nga KRU Prishtina)	
b. Leja e ndërtimit	
c. Kopja e planit	
d. Kopja e letërnjoftimit	
e. Lista e konsumatorëve individual, banesa, lokale (forma standarde e KRUP) ¹	
f. Inçizimi gjeodezik i rrjetit të Ujësjetës dhe Kan. fekal (forma standarde e KRUP) ²	
g. Situacioni i ngushtë i rrjetit të ujësjetës dhe Kan. Fekal (forma standarde e KRUP)	
h.	
i.	

4. Informacione shtesë:

Nënshkrimi i aplikuesit: _____

Data: ____/____/____

¹ Forma standarde e dhënë nga KRU Prishtina bashkë me vendimin për Kushtet Teknike

² Forma standarde e dhënë nga KRU Prishtina bashkë me vendimin për Kushtet Teknike

Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

APROVIMI I KUSHTEVE TEKNIKE

Në mbështetje të Rregullores nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë, Rregullores nr./2026 për Procedurat e kushteve teknike dhe Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, si dhe pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. _____ të datës _____, Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit në KRU "Prishtina" Sh.A., merr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa e z./znj. _____, me nr. _____, datë _____, për lëshimin e Kushteve Teknike për lidhje në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit për objektin _____, i cili ndodhet në _____.

Obligohet aplikuesi që:

- Të zbatojë në tërësi specifikimet teknike të përcaktuara në **Shtojcën** ____ (Kushtet Teknike), e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi;
- Të realizojë punimet në përputhje me standardet teknike të KRU "Prishtina" Sh.A. dhe legjislacionin në fuqi;
- Të njoftojë kompaninë para fillimit dhe pas përfundimit të punimeve për qëllime inspektimi dhe pranimit teknik.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi, verifikimit të plotësimit të kriterëve të përcaktuara me rregullore dhe pas inspektimit në terren, është konstatuar se ekzistojnë kushtet teknike dhe infrastrukturorë për realizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit.

Nga analiza teknike rezulton se aplikuesi ka përmbushur kërkesat e parapara sipas rregulloreve në fuqi dhe standardeve të kompanisë. Bazuar si më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave në KRU "Prishtina" Sh.A., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari Përgjegjës
Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit (DPZH)

(Emri dhe nënshkrimi)

Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

REFUZIM I KUSHTEVE TEKNIKE

Në mbështetje të Rregullores nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë, Rregullores nr./2026 për Procedurat e kushteve teknike dhe Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, si dhe pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. _____ të datës _____, Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit në KRU "Prishtina" Sh.A., merr këtë:

VENDIM

Refuzohet kërkesa e z./znj. _____, me nr. _____, datë _____, për lëshimin e Kushteve Teknike për objektin _____, i cili ndodhet në _____.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi, verifikimit të kriterëve të përcaktuara me rregullore dhe pas inspektimit në terren, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet teknike për realizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit.

Konstatimi teknik ka rezultuar negativ për shkak të mosplotësimit të një ose më shumë kriterëve të kërkuara sipas standardeve të KRU "Prishtina" Sh.A. dhe legjislacionit në fuqi.

Për rrjedhojë, kërkesa për dhënien e Kushteve Teknike refuzohet.

Bazuar si më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave në KRU "Prishtina" Sh.A., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari Përgjegjës
Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit (DPZH)

(Emri dhe nënshkrimi)

Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

APROVIM I EKZEKUTIMIT TË LIDHJES/KYÇJES

Në mbështetje të Rregullores nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë, Rregullores nr. /2026 për Procedurat e kushteve teknike dhe Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, si dhe pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. _____ të datës _____, Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit në KRU “Prishtina” Sh.A., merr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa e z./znj. _____, me nr. _____, datë _____, për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit për objektin _____, i cili ndodhet në _____.

Obligohet Departamenti i Ujit të Pijës dhe Departamenti i Kanalizimit që të bëjë ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit për objektin e lartcekur, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe standardet e KRU “Prishtina” Sh.A.

Z./Znj. _____ obligohet të përmbushë të gjitha detyrimet financiare sipas ARRU dhe teknike që ndërlidhen me realizimin e ekzekutimit/legalizimit të lidhjes. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Pas shqyrtimit të lëndës dhe informacioneve të detajuara nga departamentet përkatëse, dhe kërkesës së komisionit është konstatuar se aplikuesi i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara nga KRU “Prishtina” Sh.A. për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit. Për rrjedhojë, është aprovuar ekzekutimi i lidhjes, i cili do të realizohet nga KRU “Prishtina” Sh.A. sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 01/2026 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit.

Bazuar si më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave në KRU “Prishtina” Sh.A., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e pranimi të këtij vendimi.

Zyrtari Përgjegjës
Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit (DPZH)

(Emri dhe nënshkrimi)

Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

REFUZIMI I EKZEKUTIMIT TË LIDHJES

Në mbështetje të Rregullores nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë, Rregullores nr./2026 për Procedurat e kushteve teknike dhe Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, si dhe pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. _____ të datës _____, Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit në KRU "Prishtina" Sh.A., merr këtë:

VENDIM

Refuzohet kërkesa e z./znj. _____, me nr. _____, datë _____, për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit, si e pakompletuar. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Pas shqyrtimit të lëndës dhe informacioneve të detajuara nga Komisioni për pranim teknik, Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit ka konstatuar se aplikuesi nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga KRU "Prishtina" Sh.A. për realizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit për objektin _____, në pajtim me Rregulloren nr. 01/2026 për Procedurat e kushteve teknike dhe lidhjes së konsumatorëve në shërbime të ujit dhe raportit të komisionit.

Aplikuesit i mungojnë këto dokumente:

Bazuar si më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


KËSHILLË JURIDIKE

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave në KRU "Prishtina" Sh.A., brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari Përgjegjës
Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit (DPZH)

(Emri dhe nënshkrimi)

Shtojca 1 KOLEKTIVE : Shpjegimi i pikës së lidhjes dhe lokacionit për vendosjen e pusëtës së ujëmatësit kryesor dhe pusëtës kontrolluese të kanalizimit.



Legjenda:

- ✓ P-Pika e Kyçjes
- ✓ PU-Puseta e Ujësjellësit
- ✓ PK-Puseta e Kanalizimit
- ✓ KP-Kufiri i Pronës së Konsumatorit
- ✓ RU-Rjeti i Ujësjellësit-Gypi Primar
- ✓ RK-Rrjeti i Kanalizimit-Kolektori
- ✓ VN-Vija Ndërtimore
- ✓ VRR-Vija Rregulluese

[illegible]

- ✓ P-Pika e Kyçjes
- ✓ PU-Puseta e Ujësjiellësit
- ✓ PK-Puseta e Kanalizimit
- ✓ KP-Kufiri i Prones se Konsumatorit
- ✓ RU-Rjeti i Ujësjiellësit-Gypi Primar
- ✓ RK-Rrjeti i Kanalizimit-Kolektori

SHPJEGIM:

1. Shpenzimet totale të punimit të lidhjes/kyçjes së konsumatorit në rrjetin e ujësjellësit janë përgjegjësi e konsumatorit;
2. Shpenzimet totale të punimit të kyçjes së konsumatorit në rrjetin e kanalizimit janë përgjegjësi e konsumatorit;
3. Shpenzimet e mirëmbajtjes së gypit të rrjetës së ujësjellësit deri te ujëmatësi kryesor, përfshirë pusetën kryesore janë përgjegjësi e KRU "Prishtina" Sh.A.
4. Shpenzimet e mirëmbajtjes së gypit të rrjetës së kanalizimit deri te puseta kontrolluese kryesore janë përgjegjësi e KRU "Prishtina" Sh.A.
5. Shpenzimet e mirëmbajtjes së gypit të ujësjellësit nga puseta deri në hyrje të banesës apo shtëpisë, objekteve tjera institucionale dhe bizneseve janë përgjegjësi e konsumatorit;
6. Shpenzimet e mirëmbajtjes së gypit të kanalizimit nga puseta deri në hyrje të banesës apo shtëpisë, objekteve tjera institucionale dhe biznese janë përgjegjësi e konsumatorit.